



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.3.2023

Nr: 180

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. RODOLF LLAMBI XHILLARI, ME FUNKSION ANËTAR NË
KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË**

Sot më datë 18.3.2023, në seancë publike mora në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Rodolf Llambi Xhillari, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Rodolf Llambi Xhillari, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Data: 18.3.2023 Nr: 180
Ora: 11:00



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari, me funksion anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Anëtari në Këshillin e Bashkisë".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Rodolf Llambi Xhillari, aktualisht me funksionin anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, më datë 9.9.2021, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 2180 unik. KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 6409 prot, datë 13.9 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 6409/1, prot, datë 17.9.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 6410 prot, datë 13.9 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 6410/1 prot, datë 30.9.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari, rezulton të ketë ndryshuar përbërësit e gjendjes civile (emër, mbiemër) nga Roland Qirici në Rodolf Xhillari.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezultoi se kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjedhshmërisë dhe me vendimin nr.454, datë 23.9.2021, ka njoftuar këshillin bashkiak të vijojë procedurat e mëtejshme për dhënien e mandatit.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Rodolf Llambi Xhillari (Roland Llambi Qirici), rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjenealitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga "ROLAND" në "RODOLF" dhe mbiemrin nga "QIRICI" në "XHILLARI".
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 5 "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO" duke deklaruar masën

shtrënguese të sigurisë “Arresti në burg” (revokuar).

- Në datën 15.3.1996 deri më 15.6.1966 Gjykata e Shkallës së Parë Athinë, Greqi, e ka akuzuar për veprën penale “Kontrabandë e mallrave me akcizë në doganën greke”. Z. Rodolf Llambi Xhillari (Roland Llambi Qirici) ka deklaruar se është shpallur i pafajshëm.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 6408 prot., datë 13.9.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 1324/53 prot., datë 13.3.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Rodolf Llambi Xhillari, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari, sipas të cilit konstatohet si me poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjenealitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Nuk rezulton të jetë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- Nuk rezulton të jetë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qenë nën hetim dhe gjykim nga një autoritet gjyqësor i shtetit grek, për veprën penale të kontrabandës, parashikuar nga neni 100/1/b dhe 102/1/b/c të Kodit Penal Grek, me rezultat përfundimtar pafajësi;
- Rezulton të jetë arrestuar, në shtetin grek akuzuar për veprën penale “Kontrabandë në vazhdimësi”, arrestuar më datë 15.3.1995, sipas vendimit nr. 122/14-2-1995 dhe liruar më datë 15.6.1995, duke u shpallur i pafajshëm.
- Nuk rezulton të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë deportuar /dëbuar nga një shtet i huaj;

Për sa më sipër subjekti vetëdeklarues, z. Rodolf Llambi Xhillari, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e

integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Rodolf Llambi Xhillari, me detyrë anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI